



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:198668

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05574946

P.nr.290/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Z.LL, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.1638/2022 e datës 22.10.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **21.02.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit Z.LL se bashku me mbrojtësin e tij av. Getuar Zekaj, i caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Z.LL, nga i ati Rr. dhe e ëma H. e gjinisë H., i lindur me datë . në L., ku dhe jeton në fshatin I.P rr. “Llapi” nr.24, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i punësuar, zyrtar korrektues në Burgun e Dubravës, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datën 06.08.2022, rreth orës 14:50 minuta, në fshatin Istog i Poshtëm Komuna Istog, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët Ligji Nr.05/L-022, përdorë armën e tij zyrtare, në atë mënyrë që i pandehuri në kohen dhe vendin e lartcekur në shtëpinë e tij gjatë organizimit të një ahengu familjar, përdorë armen e tij zyrtare të llojit Pistolet “Glock”, model 9x19, prodhim austriak, me nr. serik RBV606, kalibër 9 mm, me të cilën shtënë në ajër tre (3)

herë, pas njoftimit të policisë nga vendi i ngjarjes evidentohen tri (3) gëzhoja të predhave, ndërsa nga i pandehuri sekuestrohet ama e zjarrit-zyrtare me karikator të zbrazet.

- me çka ka kryer veprën penale **përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 79 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurin e :

GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit Z.LL, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet*, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
 - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II.** **Nga i pandehuri Z.LL, konfiskohet arma zyrtare** - një (1) Pistolet “Glock”, model 9x19, prodhim austriak, me nr. serik RBV606, kalibër 9 mm dhe një (1) karikator i zbrazët i të njëjtës pistoletë, te cilat janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë - Qendrës Korrektuese në Dubravë, të cilat sende aktualisht ndodhen ne dhomën e dëshmime në Stacionin Policor në Istog, numri i rastit 2022-DF-421. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi **URDHEROHET** që këto sende të lartcekura, nga Policia e Kosovës ti kthehen në shfrytëzim pronarit - Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- III.** **OBLIGOHET** i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- IV.** Palë të dëmtuar nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1638/2022 e datës 22.10.2022, kundër të akuzuarit Z.LL i akuzuar për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 21.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri Z.LL se bashku me mbrojtësin e tij av. Getuar Zekaj, i caktuar sipas detyrës zyrtare, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohej për pranimin e fajësisë apo të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri Z.LL, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, dhe i premtun gjykatës se ne te ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit për veprën penale e cila i bije në barrë, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës dhe kërkojmë nga gjykata që ky pranim fajësie të aprovohej.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Getuar Zekaj lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ka deklaruar se: pasi që i mbrojturi im e pranoj fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, këtë pranim e ka bërë në konsultim me mua si avokat mbrojtës dhe se pranimin e ka bërë që nga fillimi i procedurës ndaj tij dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin pranim të aprovoj, dhe se i njëjti e kupton rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer, premtun se nuk do të kryej vepra tjera penale dhe sjellja e tij do të jetë konform ligjit, ndërsa gjykatës i propozojmë që me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese si në vijim: pranimin e fajësisë ne të gjitha fazat e procedurës, faktin që i mbrojturi im nuk ka renë asnjëherë ndesh me ligjin, keqardhjen e tij për veprimin e kryer, sjelljen e tij pas incidentit të ndodhur, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se gruaja e tij vuan nga një sëmundje e rëndë siç është ceroza e mëlçisë dhe faktin se i njëjti nuk do ta përsërisë këtë apo ndonjë veprë tjetër penale, andaj duke iu referuar të lartcekurave i propozoj gjykatës që konform kufijve ligjor të zbutjes së dënimit e ne veçanti dispozitave ligjore nga neni 71 e 72 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, dënimin eventual të shqiptuar me burgim ta zëvendësoj në gjobë.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk

përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është pendur për këtë veprim dhe premtimin se në të ardhme do të ketë sjellje të mira; ndërsa **rrethana rënduese** gjykata nuk ka gjetur intenzitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, ngase me veprime të tilla i pandehuri edhe pse si person zyrtar e ka ditur se në cilat raste përdoret arma zyrta, i njëjti duke i anashkaluar këto, përdor armë zyrta në zonë të banuar duke rrezikuar qytetarët në atë zonë të banimit. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen veprë tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Vendimi për konfiskim

Gjykata konform nenit 367 par.3 të KPRK-së dhe nenit 276 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konfiskuar armën zyrtare të lartcekur e cila ka qenë në posedim tek i pandehuri sipas ID-së me numër 1006111943, të leshuar nga Republika e Kosovës - Qeveria - Ministria e Drejtësisë – Shërbimi Korrektues i Kosovës, dhe të cilën armë i pandehuri e ka përdorur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët siç përshkruhet në përshkrimin faktik të veprës penale e cila i vihet në barrë. Ndërsa, gjykata përshtatshmerisht me nenin 227 par.6 të KPP-së, meqenëse ka vërtetuar se arma lëndore është pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, urdhëroi se pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë lëndore të bashku me karikatorin e saj, të mos shkatërrohet por të kthehet në shfrytëzim tek pronari i saj - Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesat pasurore-juridike

Në këtë çështje penale, sipas aktakuzës, nuk kishte të evidentuara palë të dëmtuara.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*